



Mbrojtja e Fëmijëve është detyrë e çdonjërit
SOS Fshatrat e Fëmijëve Kosovë,
Politika për Mbrojtjen e Fëmijëve- përmbledhje për fëmijët

Të dashur fëmijë,

Dokumenti “Politika për Mbrojtjen e Fëmijëve” është një dokument shumë i rëndësishëm për organizatën tonë! Iu tregojmë të gjithëve se çfarë mendojmë ne për mbrojtjen e fëmijëve dhe si punojmë ne për të drejtat tuaja. Quket politikë meqë të gjithë- të rriturit dhe fëmijët- duhet të respektojnë atë që shkruhet aty. Ne duhet t’a respektojmë të gjithë në mënyrë që të kalojmë mirë me njëri tjetrin dhe të ndihemi të sigurtë dhe të mbrojtur. Politika e SOS Fshatrave të Fëmijëve për Mbrojtjen e Fëmijëve qartë thotë se:

Çdo lloj keqtrajtimi apo lënie pas dore e fëmijëve është e papranueshme! Mbrojtja e Fëmijëve është detyrë e çdonjërit!

Përse duhet të kemi ne një Politikë për Mbrojtjen e Fëmijëve:

- Çdo fëmijë mund të jetë në rrezik të abuzimit apo neglizhimit;
- Disa vajza dhe djem mund të kenë gjasa të keqtrajtohen më shumë për shkak se janë të sëmurë apo kanë ndonjë aftësi të kufizuar; për shkak se duken ndryshe, apo flasin një gjuhë tjetër, etj.
- Shpesh fëmijët janë keqtrajtuar prej personave të cilëve më parë i kanë besuar shumë
- Plagët e keqtrajtimit nuk duken gjithmonë. Por këto plagë duhet të shërohen në mënyrë që fëmijët të jetojnë një jetë të lumtur përsëri.

Qëllimet tjera prapa Politikës për Mbrojtjen e Fëmijëve:

SOS Fshatrat e Fëmijëve punojnë në pajtim me Konventën Ndërkombëtare për Mbrojtjen e Fëmijëve sipas së cilës ne zotohemi se do të punojmë në interesin më i mirë të fëmijës . Çdo fëmijë ka të drejtën të zhvillohet plotësisht, të ketë arsimim kualitativ, pjesëmarrje dhe të mos diskriminimohet. Çdo njeri ka përgjegjësinë të mbrojë fëmijët nga çdo formë e abuzimit, braktisjes, eksploatimit, dhunës dhe diskriminimit. Në këtë politikë, i kushtohet rëndësi e veçantë punës dhe angazhimit që do të bëjmë ne për të parandaluar dhe për të reaguar ndaj abuzimit të fëmijëve brenda SOS Fshatrave të Fëmijëve.

Ky dokument shpjegon:

- Çfarë ne nënkuptojmë me “abuzim (keqtrajtim) të fëmijëve” dhe “neglizhim (lënie pas dore)”
- Çfarë SOS Fshatrat e Fëmijëve (SOS) është i gatshëm të bëjë në mënyrë që të gjithë fëmijët të ndihen të sigurtë nga çdo lloj keqtrajtimi
- Dhe çfarë të bëjmë nëse një fëmijë është dëmtuar (keqtrajtuar apo lënë pas dore)



A e dini se ka lloje të ndryshme të abuzimit (keqtrajtimit) të fëmijëve? A e dini se çfarë nënkuptojmë ne me “neglizhim”?

✂ **Abuzimi Fizik:** Disa fëmijë përjetojnë gjëra të këqija: ata përjetojnë rrahje apo keqtrajtohen në mënyra tjera të ngjashme. Por, askush nuk ka të drejtë t’i shkaktojë të tjerëve dhimbje, e aq më pak atyre që janë më të dobët! Nuk është në rregull kur prindërit apo personat që përkujdesen për fëmijët i lejojnë të tjerët që t’i trajtojnë fëmijët keq dhe nuk i ndihmojnë fëmijëve!

✂ **Abuzimi Seksual:** Është e drejtë e jotja- pa marrë parasysh a je i rritur apo fëmijë- të vendosësh vet nëse dëshiron që një person tjetër të të puth apo përkëdhel. Askush nuk ka të drejtë të të prekë me zorr apo të të detyrojë ta prekësh ti. Nëse nuk të pëlqen mënyra se si dikush të prekë apo të shikon, mund të thuash dhe duhet të thuash “JO”. Dhe askush nuk mund të të detyrojë të shikosh fotografi apo filma të neveritshëm apo me persona të zhveshur.



✂ **Neglizhimi:** Nuk është gjithmonë lehtë të rritesh. Në mënyrë që fëmijët të rriten dhe zhvillohen mirë, ata kanë nevojë për ndihmë. Është përgjegjësia e të rriturve, e posaqërisht e prindërve, t’ia ofrojnë fëmijëve këtë ndihmë. Kjo ndihmë përfshin të siguroarit se asgjë e keqe nuk do t’i ndodh fëmijëve, dhënie e ushqimit të mirë dhe të bollshëm, dhënie e mundësisë për të vijuar shkollimin dhe trajtimin e mirë dhe me dashuri. Kur të rriturit i lënë fëmijët pas dore dhe nuk përkujdesen për ta, kjo quhet neglizhim.

✂ **Abuzimi mendor:** Të rriturit nuk guxojnë t’i bëjnë fëmijët të ndihen pa vlerë dhe pa arsye për të jetuar. Nuk është në rregull që të rriturit t’i frikësojnë fëmijët vazhdimisht, të flasin keq për ta apo t’i bëjnë të duken budalla. Askush nuk guxon të kërkoj nga fëmijët obligime për të cilat ata janë ende të vegjël për t’i kryer.

✧ **Abuzimi fëmijë-fëmijë:** Abuzimi nuk ndodh vetëm mes të rriturve dhe fëmijëve por edhe në mes të vet fëmijëve. Disa fëmijë nuk e dinë se nuk është në rregull të sillen me fëmijët tjerë në mënyrë të keqe. Dhe këtë duhet t’iu shpjegojnë të rriturit fëmijëve.

✧ **Shkelja e Privatësisë së Fëmijës:** Çfardo informate rreth historisë së fëmijës, gjendjes mjekësore apo prejardhjes familjare duhet të ruhet me kujdes dhe mos të shpërndahet jashtë organizatës tonë. Privatësia e fëmijës, për shembull, shkelet me publikimin e fotografive, teksteve, etj ku paraqitet vajza apo djali pa lejen e tyre apo të kujdestarit të tyre; apo me dhënien e informatave që zbulojnë identitetin e fëmijës. SOS Fshatrat e Fëmijëve “respektojnë të drejtën e fëmijës për privatësi”.

✧ **Abuzimet Historike:** Abuzimi historik në këtë politikë do të thotë abuzimi të cilin e raporton i rrituri që e ka përjetuar në fëmijërinë e vet apo në moshën rinore sa ka qenë në kontakt me SOS Fshatrat e Fëmijëve. Shpesh ndodh që një individ nuk e raporton abuzimin deri disa vite pas ngjarjes abuzuese. Raportimet e tilla ngriten si qështje e rëndësishme për mbrotjen e fëmijëve dhe kalojnë nëpër procedurat e mbrotjtjes së fëmijëve.



Mënyra më e mirë për të parandaluar abuzimin dhe neglizhimin e fëmijëve është që ju të njihni të drejtat tuaja dhe të dini si duhet vepruar nëse ju ose ndonjë mik i juaji është në rrezik. Ne dëshirojmë të ju inkurajojmë që haptazi të flisni për mbrotjen e fëmijëve- edhe nëse ndonjëherë do të jetë vështirë për ju. Kjo do të ndihmojë të rriturit të kuptojnë më mirë se çfarë ju nevojitet juve për t’u ndjerë më të sigurtë dhe për të qenë më të mbrojtur.

SHTYLLAT KRYESORE TË POLITIKËS JANË:

a. VETËDIJËSIMI:Vetëdijësojmë mbi abuzimin e fëmijëve dhe rreziqet që sjell kjo- d.m.th Organizata SOS Fshatrat e Fëmijëve organizon trajnime për të gjithë punëtorët, bashkëpunëtorët dhe fëmijët për t'i mësuar ata rreth asaj se çka konsiderohet abuzim dhe cilat janë pasojat e abuzimit. Poashtu organizata jonë ofron mundësi që të krijohen grupe bisedash dhe takime të shpeshta ku do të diskutohet këto qështje me të gjithë.

NE JAPIM KURAJO PËR TË THYER HESHTJEN

b. PARANDALIMI:Ofrojmë udhëzime për atë se si t'i mbrojmë fëmijët nga abuzimi- d.m.th Ne krijojmë dhe ruajmë një ambient të sigurt për fëmijët dhe i caktojmë personat dhe komisionet përgjegjëse për t'u kujdesur që nuk vjen deri të abuzimi. Ne poashtu, përcjellim punën e të gjithë punëtorëve dhe bashkëpunëtorëve në SOS dhe sigurohemi që nuk vjen deri te abuzimi.

NE KRIJOJMË DHE RUAJMË AMBIENTE TË SIGURTA

c. RAPORTIMI:Krijojmë dhe ndjekim procedura të qarta dhe thjeshta të raportimit- d.m.th Ne i marrim me seriozitet të gjitha qështjet e ngritura- qofshin ato në SOS Fshat, Program të Fuqizimit të Familjes apo ndonjë program tjetër- dhe veprojmë sipas qështjes në fjalë. Ne definojmë dhe zbatojmë procedura të qarta të raportimit dhe reagimit, dhe definojmë rolet dhe përgjegjësitë e të gjithë personave të përfshirë. Ne marrim masa të shpejta dhe transparente.

PERSONAT PËRGJEGJËS JANË TË ZGJEDHUR NË ÇDO PROGRAM

d. REAGIMI:Sigurojmë që ndërmerret veprimi kur supozohet apo raportohet ndonjë rast i abuzimit të fëmijëve- d.m.th Të gjitha format e abuzimit të fëmijëve merren me seriozitet. Ne sigurojmë se reagim do të ketë gjithmonë, pa marrë parasysh se a konsiderohet abuzimi i vogël apo i madh. Në reagim ne garantojmë se do të vijohet një procedurë, ashtu që askush të mos akuzohet gabimisht dhe të mbrohen të drejtat e të gjithëve që janë të përfshirë.

GJITHNJË EKZISTON NJË ZGJIDHJE

ÇFARË BËN SOS-I PËR T'I MBROJTUR FËMIJËT NGA ABUZIMI DHE NEGLIZHIMI

✓ Çfarë dëshiron SOS-i t'i thotë fëmijëve:

- Ti ke të drejta- dhe kjo përfshin të drejtën për të thënë "JO"
- Dhuna nuk lejohet.
- Në të dëgjojmë ty dhe e marrim seriozisht mendimin tënd.

A i njeh ti të drejtat tua?

✓ Çfarë SOS-i dëshiron t'i thotë njerëzve që jetojnë dhe punojnë me fëmijët:

- Të gjithë njerëzit, dhe të gjithë fëmijët, dëshirojnë të jenë të dashur. Kjo është e rëndësishme për ne në mënyrë që të ndërtojmë marrëdhënie të mira në jetët tona. T'a afrosh fëmijën me dashuri nuk është abuzim.
- SOS Fshatrat e Fëmijëve ju përkrahin juve që të rrisni fëmijët në një atmosferë të ngrohtë, pa dhunë.
- Në rast të abuzimit, ju nuk jeni vetëm.
- Të drejtat dhe mirëqenia e fëmijëve vijnë në rend të parë.
- Merrni parasysh çdo tregues të abuzimit dhe ofroni ndihmën nëse fëmijët kanë nevojë për ju.

A ka diçka që ti dëshiron t'a ndash me të rriturit sa i përket mbrojtjes së

Çfarë të bëni në rast të abuzimit: ku duhet të drejtoheni

- Në çdo SOS Fshat, Kopsht dhe Program të Fuqizimit të Familjes ka njerëz që quhen "Persona të Besimit" ku ju mund të drejtoheni për çdo gjë që ju brengos dhe nëse dëshironi të bisedoni për diçka. Nëse mendoni se dikush ka abuzuar me ju ose nëse e keni parë që dikush po abuzon me të tjerët, ju duhet të bisedoni me këta persona të besimit. Mendimi juaj do të mirret parasysh kur zgjidhet ky person. Çdo fëmijë dhe çdo i rritur do të ketë informata se kush janë këta persona dhe se si mund të kontaktohen ata.
- Nëse keni ndonjë brengë, personi i besimit do të bisedojë me ju dhe së bashku do të vendosni për hapat e mëtejshëm. Ata do të ruajnë informatat tuaja dhe do të bisedojnë vetëm me personat tjerë përgjegjës për të gjetur zgjidhje për brengat tuaja.
- Ata poashtu do të përkujdesen që ju, apo fëmija që është abuzuar, të ndihet më mirë. Ata do të bëjnë çmos për të ju mbrojtur juve nga dëmtimet tjera.

A ka diçka tjetër që mund të bëhet në mënyrë që ti të ndihesh më i mbrojtur?

A e dini ju kush janë kujdestarët tuaj në SOS Fshat , mësuesit tuaj në shkollë?